



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 151

Tiranë – E enjte, 27 korrik 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10592, datë 20.7.2017	Për një ndryshim në dekretin nr. 7799, datë 26.10.2012, “Për dhënie të shtetësisë shqiptare”..... 7239
Dekret i Presidentit nr. 10593, datë 24.7.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7239
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3616/3, datë 21.7.2017	Mbi rregullat për zbatimin e sistemeve inteligjente në fushën e transportit rrugor dhe lidhjet me mënyrat e tjera të transportit..... 7239
Urdhër i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nr. 83, datë 19.7.2017	Për delegim kompetencash..... 7247
	Korrigjim gabimi material në ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 97, datë 5 maj 2017..... 7247

**DEKRET**

Nr. 10592, datë 20.7.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË DEKRETIN
NR. 7799, DATË 26.10.2012, “PËR
DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE”**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Ndryshimin e listës së personave që u është miratuar dhënia e shtetësisë shqiptare me dekretin nr. 7799, datë 26.10.2012, “Për dhënie të shtetësisë shqiptare”, nga 24 persona në 23 persona, duke shfuqizuar veprimin e dekretit të mësipërm për zonjën Frosina Niko Prendi, neni 1, pika 24 e dekretit.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET

Nr. 10593, datë 24.7.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 9, 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Emilio (Elmas/Emiljas) Rushan Çukani (Çukari)
2. Fatmir Arshi Erindi
3. Seda Kastriot Zoto
4. Marie (Merjeme) Omer Bastuni
5. Katerina Nikolla Bani (Hanxhara)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

UDHËZIM

Nr. 3616/3, datë 21.7.2017

**MBI RREGULLAT PËR ZBATIMIN E
SISTEMEVE INTELIGJENTE NË
FUSHËN E TRANSPORTIT RRUGOR
DHE LIDHJET ME MËNYRAT E TJERA
TË TRANSPORTIT.¹**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 77/2 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZON:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Subjekti dhe qëllimi

Ky udhëzim:

1. Krijon një kuadër në mbështetje të vendosjes së koordinuar dhe koherente dhe përdorimit të Sistemeve Inteligjente të Transportit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe përcakton kushtet e përgjithshme të nevojshme për këtë qëllim.

2. Parashikon zhvillimin e specifikimeve për veprimet brenda fushave të prioritetive të përmendura në nenin 2, si edhe për zhvillimin, kur është e përshtatshme, të standardeve të nevojshme.

3. Zbatohet për aplikimet dhe shërbimet në fushën e transportit rrugor dhe për ndërlihdjen e tyre me mënyrat e tjera të transportit, pa rënë

¹ Ky udhëzim është përafuar pjesërisht me direktivën 2010/40/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 qershor 2010, “Mbi kuadrin për vendosjen e sistemeve inteligjente në transport në fushën e transportit rrugor dhe për lidhjen me mënyrat e tjera të transportit”, nr. CELEX 32010L0040, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 207, datë 6.8.2010, faqe 113.



ndesh me çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare ose në interes të mbrojtjes kombëtare.

4. Zbatohet në përputhje me detyrimet e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Neni 2

Fushat prioritare

1. Për qëllimet e këtij udhëzimi, fushat prioritare për zhvillimin dhe përdorimin e specifikimeve dhe standardeve për ITS-në janë si më poshtë:

- a) përdorimi optimal dhe eficient i të dhënave të udhëtimit, rrjetit rrugor dhe trafikut;
- b) vazhdimësia e trafikut dhe shërbimet ITS për menaxhimin e ngarkesës së mallrave;
- c) aplikimet e ITS-së për përmirësimin dhe rritjen e sigurisë rrugore;
- d) lidhja e mjeteve rrugore me infrastrukturën e transportit.

2. Qëllimi i fushave prioritare është specifikuar në aneksin I të këtij udhëzimi.

Neni 3

Veprimet prioritare

Brenda fushave prioritare përcaktohen veprimet prioritare për zhvillimin dhe përdorimin e specifikimeve dhe standardeve, siç janë të përcaktuara në aneksin I, duke ofruar shërbime:

- a) të informacionit për udhëtimin multimodal në territorin shqiptar;
- b) të informacionit në kohë reale për të dhëna të trafikut në territorin shqiptar;
- c) procedura të të dhënave, që lidhen me informacionin pa pagesë për trafikun, lidhur me situatën e sigurisë rrugore, për të gjithë përdoruesit e rrugës, duke përfshirë edhe përdoruesit e pambrojtur të rrugës;
- d) të harmonizuara për një ndërveprim *e-call* (e-thirrje) të gjerë në territorin shqiptar;
- e) të informacionit për vende të parkimit të sigurta dhe të mbrojtura për kamionët/mjetet e tonazhit të rëndë dhe mjetet tregtare;
- f) për rezervimin e vendeve të parkimit të sigurta dhe të mbrojtura për kamionët/mjetet e tonazhit të rëndë dhe mjetet tregtare.

Neni 4

Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzimi zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1) “Sistemet Inteligjente të Transportit” ose “ITS” nënkuptojnë sistemet në të cilat teknologjitë e informacionit dhe komunikimit aplikohen në fushën e transportit rrugor, duke përfshirë edhe të infrastrukturës, mjeteve dhe përdoruesve, si dhe në menaxhimin e trafikut dhe menaxhimin e lëvizshmërisë, si dhe për ndërlidhjen me mënyrat e tjera të transportit.

2) “Ndërveprimi” nënkupton kapacitetin e sistemeve dhe proceseve kryesore të biznesit për shkëmbimin e të dhënave dhe për ndarje të informacioneve dhe njohurive.

3) “Aplikimi i ITS-së” nënkupton një instrument operacional për zbatimin e ITS-së.

4) “Shërbimi ITS” nënkupton ofrimin e një zbatimi ITS nëpërmjet një kuadri organizativ dhe operacional të mirëpërcaktuar me qëllimin për të kontribuar në sigurinë e përdoruesit, efikasitetin, komoditetin dhe/ose për të lehtësuar apo mbështetur transportin dhe operacionet e udhëtimit.

5) “Ofrues të shërbimit ITS” nënkupton çdo ofrues të një shërbimi ITS, qoftë publik apo privat.

6) “Përdorues i ITS-së” nënkupton çdo përdorues të aplikacioneve apo shërbimeve të ITS-së, duke përfshirë udhëtarët, përdoruesit e pambrojtur të rrugës, përdoruesit e infrastrukturës së transportit rrugor dhe operatorët, menaxherët e parkut të automjeteve dhe operatorët e shërbimeve të emergjencës.

7) “Përdoruesit e pambrojtur të rrugës” nënkupton përdoruesit jomotorikë rrugorë, si këmbësorë, çiklistë, motoçiklistët, nëna me karroca me fëmijë dhe personat me aftësi të kufizuar apo të reduktuar në lëvizshmëri dhe orientim.

8) “Pajisje lëvizëse” nënkupton një pajisje të komunikimit apo informacionit portativ brenda automjetit për të mbështetur detyrat e drejtimit të mjetit dhe/ose operacionet e transportit.

9) “Platformë” nënkupton një ambient funksional, teknik dhe operativ, që mundëson vendosjen, dhënien, shfrytëzimin dhe integrimin e aplikacioneve dhe shërbimeve të ITS-së.



10) “Arkitektura” nënkupton projektimin konceptual që përcakton strukturën, sjelljen dhe integrimin e një sistemi të caktuar në kontekstin e saj përreth.

11) “Ndërlidhje” nënkupton një strukturë midis sistemeve që ofron rrugë komunikimi përmes të cilave ato mund të lidhen dhe të ndërveprojnë.

12) “Pajtueshmëria” nënkupton aftësinë e përgjithshme të një pajisjeje apo sistemi për të punuar me një tjetër pajisje apo sistem pa modifikim.

13) “Vazhdimësi e shërbimeve” nënkupton aftësinë për të siguruar shërbimet shtesë/pa pengesa në rrjetet e transportit në të gjithë Shqipërinë.

14) “Të dhëna të rrugës” nënkuptojnë të dhënat mbi karakteristikat gjeometrike të infrastrukturës së rrugës, duke përfshirë edhe sinjalistikën rrugore vertikale, si dhe pajisjet e sigurisë rrugore.

15) “Të dhënat e trafikut” nënkuptojnë të dhënat historike dhe në kohë reale mbi karakteristikat e trafikut rrugor.

16) “Të dhënat e udhëtimit” nënkuptojnë të dhënat themelore, të tilla si oraret publike dhe tarifatat e transportit, të nevojshme për të siguruar informacion multimodal të udhëtimit, para dhe gjatë udhëtimit, për të lehtësuar planifikimin e udhëtimit, prenotimin dhe përshtatjen.

17) “Specifikim” nënkupton një masë detyruese që parashtron dispozitat që përmbajnë kërkesa, procedura apo rregulla të tjera të përshtatshme.

18) “Standard” nënkupton një specifikim teknik të miratuar nga një organ i njohur i standardizimit dhe është një nga si vijon:

- standarde ndërkombëtare: një standard i miratuar nga një organizatë ndërkombëtare e standardizimit dhe që vihet në dispozicion të publikut;

- standarde evropiane: një standard i miratuar nga një organ evropian standardizimi dhe vihet në dispozicion të publikut;

- standarde kombëtare: një standard i miratuar nga një organ kombëtar i standardizimit dhe vihet në dispozicion të publikut.

Neni 5

Vendosja e ITS-së

1. Autoritetet përgjegjëse të marrin masat e nevojshme që të sigurojnë që specifikimet e pranuar në përputhje me nenin 6 janë zbatuar

për shërbimet dhe aplikimet e ITS-së, kur këto janë vendosur në përputhje me aneksin II.

2. Autoritetet përgjegjëse, gjithashtu, do të bëjnë përpjekje për të bashkëpunuar në funksion të fushave prioritare, derisa nuk ka specifikime të miratuara.

Neni 6

Specifikimet

1. Autoritetet përgjegjëse së pari do të miratojnë specifikimet e nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë, ndërveprimin dhe vazhdimësinë e vendosjes dhe përdorimit operativ të ITS-së për veprimet prioritare.

2. Në kohën kur specifikimet e nevojshme për veprimet prioritare janë miratuar, autoriteti përgjegjës do të miratojë specifikimet për të siguruar pajtueshmërinë, ndërveprimin dhe vazhdimësinë e vendosjes dhe përdorimit operativ të ITS-së për veprime të tjera prioritare.

3. Kur është e përshtatshme dhe në varësi të specifikimit të fushës së mbuluar, specifikimi do të përfshijë një ose më shumë lloje të dispozitave të mëposhtme:

- a) dispozitave funksionale, që përshkruajnë rolet e palëve të ndryshme të interesit dhe fluksin e informacionit ndërmjet tyre;

- b) dispozitave teknike, që ofrohen për qëllime teknike për plotësimin e dispozitave funksionale;

- c) dispozitave organizative, që përshkruajnë detyrimet procedurale për palë të ndryshme të interesit;

- d) dispozitave të shërbimit, që përshkruajnë nivele të ndryshme shërbimesh dhe përmbajtjen e aplikimeve të tyre për ITS-në dhe shërbimet.

4. Specifikimet, kur është e përshtatshme, duhet të bazohen në standardet të referuara në pikën 18 të nenit 4 dhe në përputhje me aneksin II të këtij udhëzimi.

Neni 7

Rregullat mbi privatësinë, sigurinë dhe ripërdorimin e informacionit

1. Autoritetet përgjegjëse të sigurojnë që përpunimi i të dhënave personale në kontekstin e funksionimit të aplikacioneve dhe shërbimeve të ITS-së kryhet në përputhje me rregullat e në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të individëve, në veçanti të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.



2. Në veçanti, autoritetet përgjegjëse duhet të sigurojnë që të dhënat personale të jenë të mbrojtura kundër keqpërdorimit, duke përfshirë qasje të paligjshme, ndryshim ose humbje.

3. Pa cenuar pikën 1, për të siguruar privatësinë, përdorimi i të dhënave anonime duhet të inkurajohet, kur është e përshtatshme, për kryerjen e aplikacioneve dhe shërbimeve të saj. Të dhënat personale do të përpunohen vetëm për atë që përpunimi është i nevojshëm për kryerjen e aplikacioneve dhe shërbimeve të ITS-së.

4. Në lidhje me kategori të veçanta të të dhënave personale që janë të përfshira, autoritetet përgjegjëse duhet të sigurojnë që dispozitat për përpunimin e të dhënave personale duhet të respektohen.

Neni 8

Rregullat mbi përgjegjësinë

1. Autoritetet përgjegjëse të sigurojnë që çështjet që lidhen me përgjegjësinë, për sa i përket vendosjes dhe përdorimit të aplikacioneve dhe shërbimeve të ITS-së të përcaktuara në specifikimet e miratuara sipas nenit 6, janë trajtuar në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar.

2. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARSH) administron:

a) Sistemin e menaxhimit të trafikut, që nënkupton një sistem i cili konsiston në instalimin e pajisjeve stacionare trafikmatëse në akset kryesore të rrjetit rrugor kombëtar. Ky sistem i ofron ARSH-së të dhëna trafiku në kohë reale dhe është në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi monitorimin e trafikut në rrjetin rrugor kombëtar.

b) Qendrën e Monitorimit dhe Kontrollit të Trafikut Rrugor, që ka për qëllim përfshirjen e shërbimeve ITS dhe për realizimin e këtij qëllimi, bashkëpunon me Institutin e Transportit dhe Policinë Rrugore.

c) Sistemin “WEB-GIS”, që është një sistem i cili shërben si një inventar i hollësishëm i rrjetit rrugor kombëtar, duke ndihmuar në miradministrimin e të dhënave përkatëse. Ky sistem është ndërtuar konform standardeve

evropiane INSPIRE dhe ligjit 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor”.

Neni 9

Komiteti i transportit për planifikimin e ITS-së

Në zbatim të këtij udhëzimi, me urdhër të ministrit përgjegjës për transportet dhe infrastrukturën, krijohet një komitet i transportit për ITS-në, për planifikimin e veprimeve prioritare, si dhe koordinimin e iniciativave në zbatim të teknologjive të informacionit të transportit rrugor dhe multimodal, në ndërveprim me llojet e tjera të transportit, siç janë ai hekurudhor dhe i kombinuar, detar dhe ajror, dhe sektorëve të infrastrukturës.

Neni 10

Grupi këshillues për zbatimin e ITS-së

1. Për të përdorur në mënyrë efektive rrjetet e transportit rrugor dhe multimodal, do të formohet një grup këshillues për zbatimin e ITS-së, për të dhënë sugjerime për komitetin e transportit për ITS-në, në aspektin tregtar dhe teknik të vendosjes dhe përdorimit të ITS-së, në të gjithë territorin shqiptar. Ky grup do të përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë, nga ofruesit e shërbimeve përkatëse ITS, shoqatat e përdoruesve të aplikacioneve ITS në sektorin e transportit dhe infrastrukturës, operatorët e transportit rrugor dhe multimodal në ndërveprim me llojet e tjera.

2. Operatorët e tjerë përfshijnë, për sa është e mundur, transportuesit hekurudhorë dhe intermodal e të kombinuar, detar dhe ajror, si dhe operatorët e impianteve të shërbimit apo objekteve, industrinë e krijimit të këtyre aplikacioneve ITS, partnerët socialë, shoqatat profesionale, autoritetet lokale dhe forume të tjera përkatëse në platformat e konsultimit të autoriteteve përgjegjëse me palët e interesit.

3. Grupi këshillues dhe operatorët e tjerë, të cituar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, udhëzohen për të kontribuar, ku është e nevojshme, për zbatimin aktual dhe të mëtejshëm të vendimit nr. 811, datë 16.11.2016, të Këshillit të Ministrave mbi miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020, në koordinimin e praktikave të tyre më të mira me veprimet prioritare të sektorit të transportit dhe infrastrukturës.



Anekset I dhe II janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Sokol Dervishaj

ANEKSI I
FUSHAT DHE VEPRIMET PRIORITARE
(siç përmendet në nenet 2 dhe 3)

- Fusha prioritare I: Përdorimi optimal dhe eficient i rrjetit rrugor, trafikut dhe të dhënave të udhëtimit. Specifikimet dhe standardet për një përdorim optimal të rrugës, trafikut dhe të dhënave të udhëtimit do të përfshijnë si në vijim:

1. Specifikimet për veprimin prioritar (a)

- Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për të bërë ofrimin e shërbimeve të plota të informacionit për udhëtimin multimodal në territorin shqiptar përmes kufijve të saktë dhe në dispozicion të gjithë përdoruesve të ITS-së, në bazë të:

- disponueshmërisë dhe qasjes së rrugës ekzistuese dhe të sigurt, si dhe të dhënat e trafikut në kohë reale që përdoren për informacion për udhëtimin multimodal për ofruesit e shërbimit ITS, pa cenuar sigurinë dhe menaxhimin e përmbajtjes së transportit;

- lehtësimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet autoriteteve përkatëse publike dhe palëve të interesuara dhe ofruesit përkatës të shërbimit të ITS-së përtej kufijve;

- përditësimin në kohë reale të rrugës dhe komunikacionit në dispozicion të të dhënave të përdorura për informacion të udhëtimit multimodal nga autoritetet përkatëse publike dhe palëve të interesuara;

- përditësimin në kohë reale të informacionit për udhëtimin multimodal nga ofruesit e shërbimit të saj.

2. Specifikimet për veprimin prioritar (b)

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për mbledhjen nga autoritetet përkatëse publike dhe/ose nga sektori privat i rrugëve, ku është e nevojshme, i të dhënave të trafikut në kohë reale (për shembull, planet e qarkullimit, rregullat e trafikut dhe rrugët e rekomanduara, sidomos

mjetet e rënda për mallra, mjetet që transportojnë lëndë djegëse dhe mallra të tjera të rrezikshme) dhe për sigurimin e tyre për ofruesit e shërbimit ITS, në bazë të:

- disponueshmërisë, për ofruesit e shërbimit ITS, të dhëna në kohë reale për rrugët dhe trafikun ekzistues (për shembull, planet e qarkullimit të trafikut, rregullat e trafikut dhe rrugët e rekomanduara) të mbledhura nga autoritetet përkatëse publike dhe/ose sektori privat;

- lehtësimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet autoriteteve përkatëse publike dhe ofruesit e shërbimit ITS;

- përditësimin në kohë reale, nga autoritetet përkatëse publike dhe/ose, sipas rastit, sektori privat, i të dhënave të rrugëve dhe trafikut (për shembull, planet e qarkullimit të trafikut, rregullat e trafikut dhe rrugëve të rekomanduara);

- përditësimin në kohë reale, nga ofruesit e shërbimit ITS, të shërbimeve të saj dhe aplikacioneve që përdorin këto të dhënave për rrugët dhe trafikun.

3. Specifikimet për veprimet prioritare (a) dhe (b)

3.1. Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për mbledhjen nga autoritetet përkatëse publike dhe/ose, ku është e nevojshme, nga sektori privat i rrugëve dhe të dhënave të trafikut (për shembull, planet e qarkullimit të trafikut, rregullat e trafikut dhe rrugët e rekomanduara, sidomos automjetet e rënda për transportin e mallrave) dhe për sigurimin e tyre për ofruesit e shërbimit ITS, në bazë të:

- disponueshmërisë për ofruesit e shërbimit ITS, të dhëna për rrugët dhe trafikun ekzistues (për shembull, planet e qarkullimit të trafikut, rregullat e trafikut dhe rrugët e rekomanduara) të mbledhura nga autoritetet përkatëse publike dhe/ose sektori privat;

- lehtësimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet autoriteteve përkatëse publike dhe ofruesit e shërbimit ITS;

- përditësimin në kohë, nga autoritetet përkatëse publike dhe/ose, sipas rastit, sektori privat, i të dhënave të rrugëve dhe trafikut (për shembull, planet e qarkullimit të trafikut, rregullat e trafikut dhe rrugëve të rekomanduara);

- përditësimin në kohë, nga ofruesit shërbimit ITS, të shërbimeve të saj dhe aplikacioneve që përdorin këto të dhënave për rrugët dhe trafikun.



3.2. Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për të mbledhur të dhënat për rrugët, trafikun dhe shërbimet e transportit duke përdorur hartat digjitale të sakta dhe në dispozicion, ku është e mundur, për të digjitalizuar hartën e prodhuesit dhe ofruesit të shërbimeve, bazuar në:

- disponueshmërinë e të dhënave të përdorura për rrugët dhe trafikun ekzistues për hartat digjitale të prodhuesve të hartës digjitale dhe ofruesve të shërbimeve;

- lehtësimin e shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet autoriteteve përkatëse publike dhe palëve të interesuara dhe prodhuesve privatë të hartës digjitale dhe ofruesve të shërbimeve;

- përditësimin në kohë të të dhënave për rrugët dhe trafikun për hartat digjitale nga autoritetet përkatëse publike dhe palëve të interesuara;

- përditësimin në kohë të hartave digjitale nga prodhuesit e hartës digjitale dhe ofruesit e shërbimeve.

4. Specifikimet për veprimin prioritar (c)

- Përcaktimi i kërkesave minimale për sigurinë rrugore i lidhur me “informacionin e trafikut universal”, kur është e mundur, jepet pa pagesë për të gjithë përdoruesit, si dhe përmbajtjen e tyre minimale, duke u bazuar në:

- Identifikimin dhe përdorimin e një listë të standardizuar të sigurisë të lidhur me ngjarjet në komunikacion (“mesazhe universale të trafikut”), të cilat duhet t'i komunikohen përdoruesit të tij pa pagesë.

- Pajtueshmërinë dhe integrimin e “mesazheve universale të trafikut” në shërbimet e tyre për trafikun në kohë reale dhe informacionin për udhëtimin multimodal.

- Fushën prioritare II: vijueshmëria e trafikut dhe shërbimet ITS për menaxhimin e mallrave.

- Specifikimet dhe standardet për vijueshmërinë dhe ndërveprimin e trafikut dhe të shërbimeve për menaxhimin e mallrave, në mënyrë të veçantë në rrjetin rrugor kombëtar, do të përfshijnë:

1. Specifikimet për veprime të tjera

1.1. Përcaktimi i kërkesave minimale të nevojshme për vazhdimësinë e shërbimeve ITS, në veçanti për shërbime ndërkufitare, për menaxhimin e transportit të mallrave në mënyrat e ndryshme të transportit, në bazë të:

- lehtësimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave të trafikut dhe të informacionit përtej

kufijve, dhe kur është e përshtatshme, në rajone, ose midis zonave urbane dhe ndërrurbane midis qendrave të rëndësishme të informacionit/të kontrollit për trafikun dhe aktorë të ndryshëm;

- përdorimit të rrjedhjes së informacionit të standardizuar ose ndërlidhjes së trafikut midis qendrave të rëndësishme të informacionit/të kontrollit të trafikut dhe të aktorëve të ndryshëm.

1.2. Përcaktimit të kërkesave minimale të nevojshme për vazhdimësinë e shërbimeve ITS për menaxhimin e mallrave përgjatë korridoreve të transportit dhe të gjitha mënyrave të ndryshme të transportit, në bazë të:

- lehtësimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave të trafikut dhe të informacionit përtej kufijve dhe, kur është e përshtatshme, në rajone, ose midis zonave urbane dhe ndërrurbane midis qendrave të rëndësishme të informacionit/të kontrollit për trafikun dhe aktorë të ndryshëm;

- përdorimit të rrjedhjes së informacionit të standardizuar ose ndërlidhjes së trafikut midis qendrave të rëndësishme të informacionit/të kontrollit të trafikut dhe të aktorëve të ndryshëm.

1.3. Përcaktimi i masave të nevojshme në realizimin e kërkesave të ITS-së (sidomos në ndjekjen dhe gjetjen e mallrave përgjatë udhëtimit të tij dhe të gjithë llojeve të transportit), për logjistikën e transportit të mallrave (*e-Freight*), bazuar në:

- disponueshmërinë e teknologjive përkatëse ITS dhe përdorimi i tyre nga zhvilluesit aplikimeve të ITS-së;

- integrimin e rezultateve të pozicionimit në mjetet e menaxhimit të trafikut dhe qendrat.

1.4. Përcaktimi i ndërlidhjes së nevojshme për të siguruar ndërveprimin dhe pajtueshmërinë ndërmjet arkitekturës ITS urbane dhe arkitekturës europiane ITS, në bazë të:

- disponueshmërisë së transportit publik, planifikimit të udhëtimit, kërkesës së transportit, të dhënave të trafikut dhe të dhënave të parkimit në qendrat e kontrollit urban dhe ofruesit e shërbimeve;

- lehtësimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes të qendrave të ndryshme të kontrollit urban dhe ofruesve të shërbimeve për transportin publik ose privat ndërmjet të gjitha mënyrave të mundshme të transportit;

- integrimin të të gjitha të dhënave dhe informatave përkatëse në një arkitekturë të vetme.



1.5. Përkufizimi i ndërlidhjes së nevojshme për të siguruar ndërveprimin dhe pajtueshmërinë ndërmjet arkitekturës ITS urbane dhe arkitekturës ITS në gjithë territorin shqiptar, në bazë të:

- disponueshmërisë së transportit publik, planifikimit të udhëtimit, kërkesës së transportit, të dhënave të trafikut dhe të dhënave të parkimit në qendrat e kontrollit urban dhe ofruesit e shërbimeve;

- lehtësimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes të qendrave të ndryshme të kontrollit urban dhe ofruesve të shërbimeve për transportin publik ose privat ndërmjet të gjitha mënyrave të mundshme të transportit;

- integritit të të gjitha të dhënave dhe informatave përkatëse në një arkitekturë të vetme.

- Fusha prioritare III: aplikimet e ITS-së për sigurinë rrugore, specifikimet dhe standardet për aplikimet e ITS-së për sigurinë rrugore do të përfshijnë si në vijim:

1. Specifikimet për veprim prioritar

Përcaktimi i masave të nevojshme për sigurimin e harmonizuar të një *e-call* (e-thirrje) ndërvepruese të gjerë të BE-së, duke përfshirë:

- disponueshmërinë e kërkuar në të dhënat e ITS-së në automjet që do të shkëmbehen;

- disponueshmërinë e pajisjeve të nevojshme në qendrat e reagimit emergjent për marrjen e të dhënave të emetuara nga mjetet;

- lehtësimin e shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes të automjeteve dhe qendrave të reagimit të emergjencës.

2. Specifikimet për veprim prioritar

Përcaktimi i masave të nevojshme për të kuptuar informacionet bazë të ITS-së shërbejnë për vende të sigurta dhe të mbrojtura parkimi për kamionë dhe automjete komerciale (tregtare), në veçanti në shërbim dhe në pjesë të tjera në rrugë, në bazë të:

- disponueshmërisë së informacionit për parkimin në rrugë për përdoruesit;

- lehtësimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet vendeve të parkimit rrugor, qendrave dhe automjeteve.

3. Specifikimet për veprim prioritar

Përcaktimi i masave të nevojshme për të ofruar shërbime të sigurta dhe të mbrojtura të ITS-së për vendet rezervë të parkimit për

kamionë dhe automjete komerciale (tregtare) në bazë të:

- disponueshmërisë së informacionit për parkimin në rrugë për përdoruesit;

- lehtësimit të shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet vendeve të parkimit rrugor, qendrave dhe automjeteve;

- integrimin e teknologjive të rëndësishme ITS në automjete dhe parking, së bashku për të rinovuar informacionin mbi mundësitë e parkimit për qëllime të rezervimit.

4. Specifikimet për veprime të tjera

4.1. Përcaktimi i masave të nevojshme për të mbështetur sigurinë e përdoruesve të rrugës në realizimin e ndërlidhjes mes njeriut dhe automjetit dhe përdorimin e pajisjeve lëvizëse, për të mbështetur detyrën lëvizëse dhe/ose funksionimin e transportit, si dhe sigurinë e komunikimit në automjet.

4.2. Përcaktimi i masave të nevojshme për të përmirësuar sigurinë dhe komoditetin e përdoruesve të rrugës të pambrojtur dhe me aftësi të kufizuara për të gjitha aplikacionet përkatëse të ITS-së.

- Fusha prioritare IV: lidhja mes automjetit me infrastrukturën e transportit.

Specifikimet dhe standardet për lidhjen mes automjeteve me infrastrukturën e transportit do të përfshijnë si në vijim:

1. Specifikimet për veprime të tjera

1.1. Përcaktimi i masave të nevojshme për të integruar aplikimet e ndryshme të ITS-së në një platformë të hapur në automjet, në bazë të:

- identifikimit të kërkesave funksionale të aplikacioneve ekzistuese ose të planifikuara të ITS-së;

- përcaktimit të një arkitekture të hapur të sistemit i cili përcakton funksionalitetet dhe ndërlidhjet e nevojshme për ndërveprim/interkonjeksion me sistemet e infrastrukturës dhe objekteve;

- integritit të aplikimeve të ITS-së të përmirësuara dhe të reja në një mënyrë “plug and play” në një platformë të hapur në automjete;

- përdorimit të një procesi të standardizimit për miratimin e arkitekturës dhe të hapur për specifikimet në automjet.

1.2. Përcaktimi i masave të nevojshme për progres të mëtejshëm në zhvillimin dhe zbatimin sistemeve të bashkëpunimit (automjet - automjete,



automjete - infrastrukturë, infrastrukturë - infrastrukturat), duke u bazuar në:

- lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave ose informacioneve në mes të automjeteve, infrastrukturave dhe në mes të automjeteve dhe infrastrukturës;

- disponueshmërinë e të dhënave përkatëse ose informacionit që do të shkëmbehet në automjetin përkatës ose infrastrukturën rrugore;

- përdorimin e një mesazhi format të standardizuar për shkëmbimin e të dhënave ose informacionit midis automjetit dhe infrastrukturës;

- përcaktimin e një infrastrukture të komunikimit për të dhënat apo shkëmbimin e informacionit midis automjeteve, infrastrukturave dhe në mes të automjeteve dhe infrastrukturës;

- përdorimin e proceseve të standardizimit që të miratojnë arkitekturën përkatëse.

ANEKSI II PARIMET PËR SPECIFIKIMET DHE VENDOSJEN E ITS-SË

Miratimi i specifikimeve, lëshimi i urdhëresave për standardet dhe përzgjedhjen, si dhe vendosjen e aplikacioneve dhe shërbimeve të ITS-së, do të bazohen në një vlerësim të nevojave që përfshijnë të gjitha palët e interesuara, dhe duhet të jenë në përputhje me parimet e mëposhtme:

(a) Të jetë efektive - të bëjë një kontribut të prekshëm drejt zgjidhjes së sfidave kryesore që ndikojnë në transportin rrugor në territorin shqiptar (për shembull, uljen e bllokimit të trafikut, uljen e emetimeve, përmirësimin e efikasitetit energjetik, arritja e niveleve të larta të sigurisë dhe të mbrojtjes, duke përfshirë edhe përdoruesit e pambrojtur të rrugës).

(b) Të jetë me kosto efektive – optimizimi i raportit të shpenzimeve lidhur me rezultatet, me qëllim arritjen e objektivave.

(c) Të jetë proporcionale - të sigurojë, kur është e përshtatshme, për nivele të ndryshme të arritshme të cilësisë së shërbimit dhe vendosjen, duke marrë parasysh specifikat lokale, rajonale, kombëtare dhe evropiane.

(d) Mbështetja e vazhdimësisë së shërbimeve - të sigurojë shërbime të vazhdueshme në gjithë territorin vendit, në veçanti në rrjetin trans-evropian, dhe ku është e mundur në kufijtë e saj

të jashtëm, ku shërbimet e tij janë vendosur. Vazhdimësia e shërbimeve duhet të sigurohet në një nivel të përshtatur me karakteristikat e rrjeteve të transportit në lidhjen mes vendeve, dhe kur është e përshtatshme, rajonet me rajonet dhe qytetet me zonat rurale.

(e) Ndërveprimi - të sigurojë që sistemet dhe proceset themelore të biznesit kanë kapacitet për të shkëmbyer të dhëna dhe për të shpërndarë informacione dhe njohuri për të mundësuar vendosjen efektive të shërbimit ITS.

(f) Mbështetje përputhshmërisë të sistemeve - të sigurojë, kur është e përshtatshme, aftësinë për sistemet e ITS-së për të punuar me sistemet ekzistuese që ndajnë një qëllim të përbashkët, pa penguar zhvillimin e teknologjive të reja.

(g) Respektimi i karakteristikave të rrjetit dhe infrastrukturës kombëtare ekzistuese – merr parasysh dallimet e natyrshme në karakteristikat e rrjetit të transportit, në veçanti në madhësitë e volumit të trafikut dhe në kushtet e rrugëve.

(h) Nxiti barazinë e qasjes - të mos pengojnë ose diskriminojnë qasjen në aplikacionet dhe shërbimet e ITS-së nga përdoruesit e rrugës së cenueshme.

(i) Mbështetje e maturuar - shfaq, pas vlerësimit të duhur të rrezikut, fuqitë e reja të sistemeve ITS, përmes një niveli të mjaftueshëm të zhvillimit teknik dhe shfrytëzimit operacional.

(j) Ofrimi i pozicionimit dhe cilësisë së kohës - përdorimi i infrastrukturave bazë satelitore, ose ndonjë teknologjie që ofron nivele ekuivalente të saktësisë për qëllime të aplikacioneve dhe shërbimeve që kërkojnë globalizim, vazhdueshmëri, kohë dhe pozicionim të shërbimeve të sakta dhe të garantuara të ITS-së.

(k) Lehtëson multimodalitetin - merr parasysh koordinimin e mënyrave të ndryshme të transportit, kur është e përshtatshme, për vendosjen e ITS-së.

(l) Respektimi i koherencave - merr parasysh rregullat, politikat dhe aktivitetet ekzistuese të BE-së, të cilat janë të rëndësishme në fushën e ITS-së, në veçanti në fushën e standardizimit.



URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 83, datë 19.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurës administrative të RSH-së”, neni 29

URDHËROJ:

Delegimin e kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së, znj Laura Tragaj, me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit në Mjedis, nga data 20 - 30.7.2017, periudhë në të cilën z. Julian Beqiri, me pozicion Drejtor i Përgjithshëm i AKM-së, do të kryejë lejen e zakonshme.

1. Kompetencat e deleguara janë:

a) Të përfaqësojë Agjencinë në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjëse për organizimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së kësaj Agjencie.

b) Të administrojë buxhetin e miratuar të Agjencisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) Të bashkërendojë punën për aktivitetet e kësaj Agjencie me institucionet e pushtetit qendror dhe vendor, si edhe ente të tjera publike.

2. Data e fillimit të delegimit është 21.7.2017 - 31.7.2017.

3. Delegimi i kompetencave do të botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Vlerësimit në Mjedis në AKM.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Julian Beqiri

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 97, datë 5 maj 2017, bëhen këto ndreqje:

1. Në nenin 173 të ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, në lidhje me nenin 320 të Kodit të Procedurës Penale, rreshti i fundit

Ishte:

Në pikën 4 fjala “**mund**” zëvendësohet me fjalën “duhet”.

Bëhet:

Në pikën 4 fjala “**ku mund**” zëvendësohet me fjalën “ku duhet”.

2. Në nenin 133 të ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, në lidhje me ndryshimin e pikës 8 të nenit 249 të Kodit të Procedurës Penale,

Ishte:

Në pikën 8, pas fjalës “**akteve**” shtohen fjalët “, brenda kompetencës së saj”.

Bëhet:

Në pikën 8, pas fjalës “**Lartë**” shtohen fjalët “, brenda kompetencës së saj”.

3. Neni 353 i Kodit të Procedurës Penale nuk ndryshon.

4. Neni 279 i ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017

Ishte:

Në nenin 499, pika 1, pas fjalës “ekstradim” shtohen fjalët “kur në ngarkim të personit të kërkuar ka një masë shtrënguese”.

Bëhet:

Në nenin 498, pika 1, pas fjalës “ekstradim” shtohen fjalët “kur në ngarkim të personit të kërkuar ka një masë shtrënguese”.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 84 lekë